



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.12, datë 26.05.2026

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIM
BURIMI UJOR PËR LUNDRIM PËR QËLLIME TË NDRYSHME,
ME VENDNDODHJE: REZERVUARI FUSHË STUDËN, BASHKIA
LIBRAZHD, TË SUBJEKTIT "ASTROTOURISM ALBANIA" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës "Për autorizim për përdorim burimi ujqor për lundrim për qëllime të ndryshme", të subjektit "Astrotourism Albania" sh.p.k, me vendndodhje: Rezervuari Fushë Studën, Bashkia Librazhd.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i trupit ujqor: Rezervuari Fushë Studën.


Vendndodhja e burimit ujqor (KRGJSH):

X = 534474.755

Y = 4576032.620

Z = 1160 m.m.n.d

Itinerari i rrugës që përshkohet: Brenda sipërfaqes ujqore të rezervuarit (Nisja dhe mbërritja në të njëjtën pikë).





Pika e fillimit të itinerarit (KRGJSH):

X = 534576.675

Y = 4576244.301

Z = 1160 m.m.n.d

Pika e përfundimit të itinerarit (KRGJSH):

X = 534576.675

Y = 4576244.301

Z = 1160 m.m.n.d

Numri i rrugëve që do të kryhen në vit: 280

Periudha e përdorimit të ujit: Maj - Tetor

Qëllimi i përdorimit: Lundrim për argëtim me KAYAK.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SHKUMBIN

ILIR BEJTJA

